



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit

Direkcija za Urbanizam i Zaštitu Ambiena

Department of Urban and Environmental Protection

PLANI I PUNËS I DREJTORISË PËR URBANIZËM PËR VITIN 2024

1. PUNËT ADMINISTRATIVE

Planifikohet që punët administrative të përfundohen me kohë në afatin e paraparë ligjor pa vonesa dhe ngecje edhe pse natyra e lëndëve për Drejtorinë tonë kërkon një kohë më të gjatë për zgjedhjen e lëndëve si lëndet që kanë të bëjnë Lejet Ndërtimore, ndërsa lëndet tjera si Pranimet teknike, kërkesat e ndryshme të qytetarve për projekte në infrastrukturë, pasta) vërtetime, qertifikata etj., synohet që të përfundojnë me kohë dhe pa ngecje .

Një sfid në vete është edhe ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje ku ky proces veq ka filluar aplikimin e ndërtimeve pa leje dhe vazhdon tutje sipas ligjit për legalizimin e objekteve pa leje. Nga procesi i ligjit të legalizimit planifikohet që të ketë hyra me mjete financiare në shumën prej 15,000.00€, nëse ky proces rrijedh sipas planeve të MMPH-së dhe Komunës.

Të hyra të mjeteve financiare planifikohet që te mblidhen nga lejet ndërtimore dhe të hyrat tjera administrative rreth 350,000.00€.

Drejtoria për Urbanizëm në bazë të statutit të Komunës dhe detyrave që i përkasin ka përpiluar listen e projekteve për vitin 2024 si dhe projektet të bartura nga vitet paraprake-kontrata kornizë :

2. REALIZIMI I PROJEKTEVE GJATË VITEVE PARAPRAKE DHE QE VAZHDOJN VITIN 2024-PROJEKTE DY-TRI VJEOARE

- Ndërtimi i poligonit multifunksional – faza III - (ka përfunduar)
- Asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i lumenjve në BL Klinë e Epërme, Prekaz, Turigevc, Polac, Qirez, Runik, Likoc, Rezallë - (ka përfunduar)
- Punimi i rrjetit të ujësjellësit në Burojë
- Kanalizimi Vajnik – Kopiliq - (ka përfunduar)
- Punimi i kanalizimit në BL Klinë e Epërme, Prekaz, Turigec, Polac, Qirez, Runik, Likoc dhe Rezallë
- Trotuaret dhe ndriqimi në BL Likoc, Klinë e Epërme, Polac, Runik, Turigevc
- Unaza e brendshme 3 krahuh kah Llausha
- Kanalizimi Syrganë, Banjë – Pemishtë
- Asfaltimi i rrugës në Lagjen 3 –Prekaz
- Punimi i rrjetit të ujësjellësit në BL Qirez
- Ndërtimi i Rrugës Kozhice-Qyqavice



- Ndërtimi i Rrugës Syrganë-Bjeshka e Syrganës
- Rregullimi i subqendrës –Likovc
- Rregullimi i subqendrës –Runik
- Rregullimi i subqendrës –Qirez
- Vazhdimi i punimeve të kompleksit i UÇK-së - Objekti i U-së
- Kanalizimi Prekaz-Mikushnice-Lubovec
- Kanalizimi në Bl Qirez - (ka përfunduar)
- Tribunat ne stadiumin të qytetit
- Kanalizimi Klinë - Kuqicë
- Ndërtimi i kanalizimit në Bl-Likovc faza I

Të gjitha projektet e cekura më lartë janë duke u menagjuar dhe mbikqyrur prej Drejtorisë për Urbanizëm si ato të financuara nga Kuvendi Komunal ashtu edhe projektet të cilat kanë qenë të bashkëfinancuara.

3. PROJEKTET E PARAPARA PËR VITIN 2024

- **Korigjimi i hartës zonale –HZK-së**
- **Kanalizimi Aqarëvë dhe Kopiliq i ulët**
- Kanalizimi në fshatra Bl Tuirigevc-faza III - (aneks kontratë)
- Kanalizimi në Bl Likovc-faza III (Abri-Murgë)
- Asfaltimi i rrugës Rakinicë-Qubrel - (aneks kontratë)
- **Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Kuqicë,Qubrel,Kosterc,Vitak,Klladernicë,Burojë,Vajnik,Abri,Ticë, Klinë,Prekaz.**
- Ndërtimi i rrugës Kotorr-Qubrel (aneks kontratë)
- Asfaltimi i rrugës Skenderaj –Vushtrri- (aneks kontratë)
- Asfaltimi i rrugës Runik të Kisha- (aneks kontratë)
- **Ndërtimi i urave në fshatrat Aqarëvë,Llaushë,Kuqicë,Ternavc,Tushilë,Kllodenicë**
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Izbicë-faza 2- (aneks kontratë)
- Asfaltimi i rrugës nga lagja Zabeli deri të shkolla Malush Ahmeti si dhe rrugët lidhëse - (aneks kontratë)

PROJEKTET NË BASHKFINANCIM ME INVESTTORET DHE DONATORET E JASHTËM si:

- Qeveria me Ministrinë Përkatese
- CDI-i
- CDF-i
- USAID
- Përfundimi i bulevardit Ijaz kodra
- Rregullimi i shtatit të lumit klin e ulet –kuqic dhe dy degjimet e llaushes
- Rregullimi i shtatit të lumit klina Skenderaj –tushil

Skenderaj 11.12.2023

